




Plasur / Dorezuar Punëhënës/Prodator Recipient/Deliverer	15. 03. 2023	3	viti god year
Organ /Njësia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMPSHCK	2671/2023		115



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.402/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.402/2023 të datës 23.02.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit me Nr. Ref: 14/2023 të datës 24.01.2023 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 15.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa më numër A.nr.402/2023 e datës 23.02.2023 e parashtruar nga ankues
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. Ref: 14/2023 i datës 24.01.2023 i zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit _____ punësuar sipas Akt Emërimit AE.Nr.33/2022 të datës 13.06.2022 në pozitën Zyrtar i Lartë për Shtete dhe Organizata Ndërkombëtare, zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 24.01.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. Ref: 14/2023 përmes të cilit i ka shqiptuar masën disiplinore “Vërejtje”, me arsyetimin për vones në punë nga data 04.-20.01.2023

Ankuesja kundër këtij përmes emailit ankesa.kmpshck@rks-gov.net, më datë 22.02.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila më

datë është regjistruar më datë 23.02.2023 nën shenje A.nr.402/2023 me numër protokollit 2000/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.03.2023 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli më datë 02.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 23.02.2023 e regjistruar me numër protokollit 2000/2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. Ref: 14/2023 i datës 24.01.2023 i zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Akt Emërimit AE.Nr.33/2022 i datës 13.06.2022 në emër të ankuesit; Shkresë Laboratori e datës 06.01.2023; Kupon Fiskal nga NTSH "MEDILAB HUMAN" i datës 06.01.2023; Konkursin me Nr. Reference: RN00010768 i datës 22.01.2023 për pozitën Drejtor i Departamentit për Evropë, BE dhe Rajon; Konkursin me Nr. Reference: RN00010769 i datës 22.01.2023 për pozitë Udhëheqës i Divizionit për Evropë dhe BE; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 01.03.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 02.03.2023; Raport për prezencën në punë në nivel të punëtorit për aneksin nga data 04.-20.01.2023; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesin për periudhën 16.06.-15.12.2022 dhe janar-maj 2022 i datës 31.01.2023; Vendimin me Nr. Ref:249/2022 i datës 07.09.2022 për transferim të përkohshëm të ankuesit; Emailin e datës 13.03.2023 nga V.B për A.B.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit, *është e pabazuar, sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. Ref: 14/2023 të datës 24.01.2023 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për shqiptimin e masës disiplinore "vërejtje", pretendon që masa disiplinore është shqiptuar nga personi jo kompetent sepse Sekretari i Përgjithshëm nuk është person jo kompetent; masa më është shqiptuar në mënyrë tendencize sepse në këtë kohë kam pasur djalin e sëmur dhe nuk ka mundur dy ditë në punë; po ashtu masa më është shqiptuar vetëm për të mos konkurruar në pozitën Drejtor i Departamentit për Evropë, BE dhe Rajon dhe Udhëheqës i Divizionit për Evropë dhe BE pasi që janë shpall konkurset para se të më shqiptohet masa.

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesit është i punësuar në kuadër të Divizionit për Evropë dhe BE në Departamentin për Evropë, BE dhe Rajon, ku sipas konfirmimit përmes emailit të datës 13.03.2023 është konfirmuar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që në mungesë të Drejtorit të Departamentit për Evropë, BE dhe Rajon dhe Udhëheqësit të Divizionit për Evropë dhe BE, atëherë zëvendësuesi i

Sekretarit të Përgjithshëm është mbikëqyrës i drejtpërdrejtë. Lidhur me këtë që ka deklaruar Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Kolegji i Këshillit, në bazë të provave të lëndës, konstaton se Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datë 22.01.2023 ka shpall konkursin me Nr. Reference: RN00010768 për pozitën Drejtor i Departamentit për Evropë, BE dhe Rajon dhe konkursin me Nr. reference: RN00010769 për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Evropë dhe BE. Po ashtu në bazë të provave të lëndës, respektivisht sipas Vendimit me Nr. Ref: 249/2022 të datës 07.09.2022 ankuesi është transferuar përkohësisht nga pozitë Zyrtar i Lartë për Shtete dhe organizata Ndërkombëtare në pozitën Zyrtar i Lartë për Marrëdhënie Shumëpalëshe në Divizionin për Rajon për periudhën nga data 07.09.2022 deri më datë 15.12.2022, ndërsa vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën janar-maj 2022 i është bërë nga Drejtor i Përgjithshëm ndërsa për periudhën nga data 16.06.2022 deri më datë 15.12.2022 i është bërë nga Udhëheqësi i Divizionit për Rajon.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Sekretari i Përgjithshëm nuk është mbikëqyrës i drejtpërdrejtë, është pretendim i pa bazuar për shkak që referuar nenit 18 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, i cili ka përcaktuar se: *"3. Sekretari i Përgjithshëm ka këto përgjegjësi kryesore: 3.1. mbështet ministrin në punën e tij; 3.2. siguron koordinimin e hartimit të politikave në ministrinë përkatëse; 3.3. siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit, të politikave dhe të vendimeve të ministrit; 3.4. siguron drejtimin, koordinimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e të gjithë sistemit ministror; 3.5. siguron bashkëpunimin me ministri të tjera dhe institucionet, si dhe me agjencitë e pavarura; 3.6. vendos për administrimin e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore, të sistemit ministror, në përputhje me legjislacionin në fuqi; 3.7. çdo përgjegjësi tjetër, që i caktohet me ligj apo të deleguar shprehimisht nga ministri"*, ngase për kohën kur ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore pozita e Drejtorit të Departamentit për Evropë, BE dhe Rajon dhe Udhëheqësit të Divizionit për Evropë dhe BE kanë qenë të lira dhe nuk ka qenë ndonjë nëpunës civil duke i ushtruar këto pozita, rrjedhimisht në këtë rast për nga hierarkia mbikëqyrës i drejtpërdrejtë ka qenë zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm, andaj për nga aspekti hierarkik dhe i përgjegjësisë, Vendimi me Nr. Ref: 14/2023 i datës 24.01.2023 i zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është i ligjshëm në kuptim të nenit 48 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës Vendimit me Nr. Ref: 14/2023 të datës 24.01.2023 për shqiptimin e masës disiplinore *"Vërejte"* ndaj ankuesit e ka bërë për shkak të mos respektimit të orarit të punës nga data 04-20.01.2023, respektivisht me arsyetimin e më datë 05.01.2023 ka bërë hyrje në punë në orën 10: 26, më datë 10.01.2023 ka bërë hyrje në orën 09:19, më datë 13.01.2023 ka bërë hyrje në orën 10:55, në orën 16.01.2023 ka bërë hyrje në orën 09:39, më datë 17.01.2023 ka bërë hyrje në orën 10:33, më datë 18.01.2023 ka bërë hyrje në orën 11:06 ndërsa më datë 19.01.2023 ka bërë hyrje në orën 10:35.

Lidhur me ligjshmërinë e Vendimit me Nr. Ref: 14/2023 të datës 24.01.2023 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe pretendimit

ankimor të ankuesit se masa më është shqiptuar në mënyrë tendencioze sepse në këtë kohë kam pasur djalin e sëmur dhe nuk ka munguar dy ditë në punë, Kolegji i Këshillit, konstaton se në bazë të provave të dërguara nga ankuesi i njëjti ka bashkangjitur si provë dokument nga Laboratori "MEDILAB HUMAN" të datës 06.01.2023 dhe Kuponin Fiskal nga NTSH "MEDILAB HUMAN" i datës 06.01.2023 në emër të J.B, lidhur me analizat e bëra në këtë laborator, si rrjedhojë Kolegji në bazë të provave të shqyrtuar respektivisht raportit të prezencës në punë për ankuesin për ditët që janë përshkruar në Vendimin me Nr. Ref: 14/2023 të datës 24.01.2023 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka konstatuar se pretendimet e mbikëqyrësit të drejtpërdrejte janë të qëndrueshme, ngase ankuesi për vonesat e tij në vendin e punës nuk kanë qenë të arsyetuara me ndonjë email apo njoftim paraprak, gjegjësisht i njëjti nuk ka njoftuar mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë për vonesat në punë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, lidhur me këtë çështje juridike-administrative, ju referua Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, gjegjësisht nenit 4 paragrafi 2, ku përcaktohet se: *"Orari i punës së zyrtarëve publik fillon në orën 08:00 dhe përfundon në orën 16:00, pesë (5) ditë në javë duke filluar nga e hëna deri të premten përveç nëse caktohet ndryshe nga institucioni përkatës për shkak të natyrës së punës"*, si rezultat i kësaj, ankuesi pa ndonjë arsyetim nuk ka respektuar orarin e tij të punës duke mos respektuar dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë respektivisht nenin 9 paragrafi 1, 2, 3 dhe 5, i cili përcakton se: *"1. Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë prezent në vendin e punës. 2. Çdo zyrtar publik është i obliguar që të shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik, varësisht se cilën ka në përdorim institucioni. 3. Mosregjistrimi në librat e vijueshmërisë në punë apo në regjistrin elektronik, llogaritet si mosprezencë në punë. 5. Mos respektimi i orarit të punës, sipas Ligjit përkatës për Zyrtarët Publik paraqet shkelje disiplinore"*, si rrjedhojë me veprimet e tij ankuesi ka bërë shkelje të nenit 28 të Ligjit Nr. 06/L-1114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij"*, kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se masa është shqiptuar vetëm për të mos konkurruar në pozitën Drejtor i Departamentit për Evropë, BE dhe Rajon dhe Udhëheqës i Divizionit për Evropë dhe BE pasi që janë shpall konkurset para se të më shqiptohet masa, Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimi i ankuesit është i paqëndrueshëm, ngase zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, masën ndaj ankuesit e ka shqiptuar në bazë të provave dhe fakteve të ofruara, dhe duke parë veprimet e ankuesit për mos respektim të orarit të punës në kuptim të rregullativës ligjore në fuqi dhe faktit që ankuesi nuk ka ndërmarr asnjë veprim për të njoftuar për mungesë në punë për kohë që është specifikuar në vendimin e kontestuar, atëherë Kolegji i Këshillit, konstaton se ky pretendim është i pabazuar.

Nisur nga rrethanat si më lartë Kolegji, vlerëson se zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës i ankueses me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtje" sipas Vendimit me Nr. Ref: 14/2023 të datës 24.01.2023, ka konstatuar saktë

përgjegjësinë disiplinore të ankuesit si dhe ka cilësuar drejtë veprimet e ankuesit dhe masa është shqiptuar në pajtim me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 48 paragrafi 1, 50 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, duke e arsyetuar vendimin në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, gjegjësisht me nenin 48 paragrafi 1 dhe të 2, andaj sa i përket pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji konstaton se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuar dhe të paqëndrueshme sepse i njëjti këto pretendime nuk i ka argumentuar me prova relevante.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.402/2023

Avdyl BEKTESHI
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Eshref SHABANI
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.